



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 271

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Kërkues: Partia Demokratike e Shqipërisë

Ndaj: Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak



Data: 21 Prill 2021
Nr. 271

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 25.03.2021, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, denoncimi me nr. 3269, ID unik i gjeneruar nga sistemi, ora 12:26, ku pretendohet se, në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në datë 18.04.2021, nga e-mail personal i kandidatës së Partisë Socialiste njëkohësisht dhe Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **zj. Ogerta Manastirliu** është kërkuar, që nga struktura e PS, të vijjnë propozime për vendet vakante në institucionet (listuar më poshtë) dhe arsimin përkatës për çdo vend. Emërime politike që priten të plotësohen deri në datë 25.04.2021.

1. Në NJVKSH Tiranë duhet një specialist auditi që të ketë mbaruar ekonomik dhe recepsionist në Poliklinikën Paskuqan me arsim të mesëm.
2. Në Maternitetin e Ri kërkohet magazinier me arsim të mesëm.
3. Në DRF Tiranë nevojitet një informaticien ose ingnier elektronik për një afat 1 vjeçar deri në përfundim të lejes së lindjes.
4. Në Maternitetin e Vjetër duhet një sanitare me arsim të mesëm.
5. Për ta përfunduar me ISSH ku kërkohen tre inspektorë provizor (sipas profilit shëndet publik, ekonomik, juridik).

Sipas denoncuesit, kjo vjen në shkelje me nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili parashikon se, “*Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore*” dhe me nenin 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “d” e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ku parashikohet se “*Gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat ne organiken e cdo institucioni publik e shteteror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përlligjura. Konsiderohen raste të përlligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë*”.

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit është paraqitur dhe një fotografi, ku sipas denoncuesit vertetohet pretendimi i tij.



Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 8, të vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose nëse mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se provat ku denoncimi bazohet, nuk kanë vlerë provueshmërie për të konstatuar nëse ka shkelje apo jo, pasi në fotografinë e paraqitur nuk ka asnjë element vërtetues, për tu konsideruar si indicie për nisjen e hetimit administrativ. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se **informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet**

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,



V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative ndaj zj. Ogerta Manastirliu.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI



Data: 21 Prill 2021
Nr. 271

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.